



2447
11.05.2016

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

Nr. Regj. Them. 6966/2425/400
Dt. Regj. 09.09.2014

Nr. Vendimi 929
Dt. Vendimi 27.04.2016

V E N D I M
"Në emër të Republikës"

Gjykata Administrative e Apelit me trup gjykues të përbërë prej:

Kryesuese:	Rilinda SELIMI
Anëtar:	Amarildo LAÇI
Anëtar:	Bari SHYTI

me sekretare gjyqësore **Mimoza LAZRI**, në Tiranë, sot më datë 27.04.2016 mori në shqyrtim në dhomë këshillimi çështjen administrative nr. 6966/2425/400 akti, datë regjistrimi 09.09.2014 qe u përket palëve ndërgjyqëse:

PADITËS: Shoqeria "Shpiragu/B" Sh.P.K. me qendër në Urë - Vajgurore.
TË PADITUR: Drejtoria Rajonale Tatimore Berat.
Drejtoria Apelit Tatimor, pranë Drejtorisë së Përgjithëshme të Tatimeve Tiranë.
OBJEKTI: Anullimin e gjobës 201705 lekë për rentën minerale të rrjedhur nga njoftim vlerësimi për detyrimin tatimor nr. 1109 dt.05.04.2012.
BAZA LIGJORE: Neni 32/a, 149, 324 e vijues të Kodit të Procedurës Civile, neni 1, neni 135 i Kodit Civil, neni 26 i K.Pr.Administrative, neni 6 dhe 13 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, neni 42 të Kushtetutës.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat, me vendimin Nr. 1628, datë 23.11.2012 ka vendosur:

1. *Urësimin e padisë si të pabazuar në ligj.*
2. *Shpenzimet gjyqësore në masën 12400 (dymbëdhjetëmijë e katërqind) lekë i mbeten paditësit, siç i ka bërë...*

Kundër këtij vendimi ka bërë ankim në Gjykatën e Apelit Vlorë, pala paditëse Shoqeria "Shpiragu/B" Sh.P.K., me të cilin ka kërkuar ndryshimin e vendimit dhe pranimin e kerkese padise, për shkaqet:

- Vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë Berat është rrjedhojë e interpretimit të gabuar të dispozitave ligjore që kanë të bëjnë me institutin e parashkrimit, interpretimin e normës juridike për marrëdhënien juridike objekt konflikti.
- Brenda afatit ligjor kemi paraqitur ankim administrativ pranë Drejtorisë së Apelit Tatimor.
- E drejta e shoqërisë "Shpiragu/B" sh.p.k. për të mos u sanksionuar me gjobë ka lindur që me ngritjen e kërkesë padisë pranë kësaj gjykate më datën 13.12.2011.
- Vendorsja e gjobës në masën 201.705 lekë nuk ka asnjë shkak të mjaftueshëm ligjor.
- Shoqëria në kërkesë padinë e saj nuk ka kërkuar nga gjykata hetimin gjyqësor të themelit të

aktit administrativ, por ka kërkuar vetëm efektet materiale të kërkesë padisë.

- Nuk jemi para gjyqvarësisë apo litispendencës. Shoqëria e ka ngritur njëherë një padi në datën 13.12.2011, por këto padi kanë të përbashkëta vetëm palët dhe shkakun ndërsa objekti është i ndryshëm. Objekti i padisë i datës 13.12.2011 është: 1. anulimi pjesërisht i aktit administrativ; 2. Kthimin e shumës 126.224 lekë, si një pagim i pa detyruar i paditësit; 3. Anulimin e gjobës 63.112 lekë si një shumë e kërkuar padrejtësisht. Ndërsa objekti i kësaj padie është anulimin e gjobës 201705 lekë për rentën minerale të rrjedhur nga njoftim vlerësimi për detyrimin tatimor nr.1109 dt.05.04.2012.
- Vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë të Rrethit Gjyqësor Berat Nr. 376 datë 23.3.2012 ende nuk ka marrë formë të prerë. Ky vendim nuk mund të konsiderohet se zgjidh çështjen në themel.
- Paditësi e ka paguar në mënyrë të përpiktë dhe korrekt pagesën e rentës minerare mbi koeficientin 5%. Kjo është e vërtetuar edhe nga akti i kontrollit të Njoftim Vlerësimi Nr. 1109 Prot. datë 5.4.2012.
- Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat Nr. 1628 datë 23.11.2012 për nga interpretimi bie në kundërshtim me dispozitat kushtetuese, nenet 4, 7 dhe 145 pasi gjykata nuk duhet të ndikohet nga interpretimi administrativ pasi nuk është shkallë e ankimit apo apelimit administrativ.
- Në faqen 5 të arsytimit të vendimit gjykata është shprehur apriori për themelin e aktit administrativ duke prezumuar fajësinë e paditësit, gjë për të cilën ai nuk e ka kërkuar në padi, që të shprehet mbi interpretimin dhe zbatimin e normës dmth. pagesa e rentës minerare do të aplikohet, mbi kostot e prodhimit apo mbi çmimin e shitjes. Për interpretimin dhe zbatimin e kësaj norme paditësi ka ngritur padinë në datën 13.12.2011 në këtë gjykatë dhe çështja është në Gjykatën e Apelit ku pritet të jepet edhe interpretimi gjyqësor mbi zbatimin konkret të kësaj norme mbi marrëdhënien juridike objekt gjykimi.
- Për sa i përket pjesës arsytuese të vendimit në faqen Nr. 7 pika 2, 3, 4, 5 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat ka bërë vetëm interpretim administrativ, duke u vendosur në hierarkinë e organit më të lartë administrativ për sa i përket neneve 131 gërma "b" e 135 e K.C.
- Në faqen Nr. 7 pika 2 paragrafi i fundit në vendimin e gjykatës citohet: objekti i padisë së ngritur nga paditësi në datën 13.12.2011 i referohet njoftim vlerësimit Nr. 2450 të datës 4.8.2011 dhe jo atij të datës 5.4.2012. Pra në dy raste kemi të bëjmë me detyrime të ndryshme tatimore. Dënimi me gjobë i dhënë nga Drejtoria e Tatimeve me njoftim vlerësimin e datës 5.4.2012 i referohet detyrimit tatimor të përmbajtur në këtë akt dhe jo atij objekt i shqyrtimit të padisë së datës 13.12.2011. Në këtë pjesë arsytuese të vendimit gjykata është shprehur në mënyrë të gabuar, për detyrime të ndryshme tatimore, ato kanë karakter relative, gjë e cila nuk ka të bëjë me kërkimin e paditësit apo të objektit të padisë, por ka të bëjë vetëm me marrëdhënie juridike konkrete e cila është e lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të pazgjidhshme me marrëdhënien juridike të krijuar në datën 13.12.2011 që ka ardhur nga fakti juridik i aktit administrativ Nr. 2450 datë 4.8.2011.
- Për sa i përket faktit të parashkrimit, në arsytimin e vendimit, pika 3 e faqes 7 me motivacion se instituti i parashkrimit nuk gjen zbatim në rastin e çështjes objekt gjykimi, e cila ka karakter administrativ, por Kodi i Procedurës Administrative as e ndalon në ndonjë dispozitë të tij, balanca kalon nga mbajtësi i të drejtës subjektive dhe marrin përparësi dhe zbatohen normat e procedurës civile, dhe rregullohet nga dispozitat e Kodit Civil nenet 131 gërma "b" dhe neni 135. Paditësi në padinë e tij, si në objektin e saj ashtu dhe në shkakun e saj nuk ka ngritur pretendimin dhe nuk ka kërkuar ndërprerjen e së drejtës të organeve administrative të nxjerrin akte administrative ashtu siç arsyeton gjykata në vendimin e dhënë prej saj.
- Për sa i përket arsytimit të vendimit kur flet për detyrimin tatimor që nuk është kërkuar në

padinë aktuale për të pasur mundësinë e gjobës si dhe të parashkruar me argumentin se ka marrë formë të prerë, nëse paditësi do kish kërkuar me padinë aktuale shumëën e detyrimit tatimor 403.410 lekë do të ishin para një situatë gjyqësore apo të litispencës, të dyja paditë do të ishin të njëjta në të tre komponentët e saj, palë, objekt dhe shkak. Për sa i përket shumës së detyrimit tatimor 403.410 lekë se ka marrë formë të prerë, ky qëndrim i gjykatës është i gabuar, për arsye se kjo shumë ende nuk ka marrë formë të prerë pasi vendimi i Gjykatës së Apelit Vlorë nuk është dhënë akoma.

- Përfundimisht kërkojmë nga Gjykata e Apelit Vlorë ndryshimin e vendimit civil Nr. 1628 datë 23.11.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, në bazë të nenit 446/b të K.Pr.C. anulimin e gjobës 201.705 lekë për rentën minerare të rrjedhur nga njoftim vlerësimi Nr. 1109 datë 5.4.2012 për detyrimet tatimore. Shpenzimet gjyqësore ti ngarkohen të paditurit.

Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin Nr. 703 (60-2014-1009) date 22.04.2014 ka vendosur:

"Shpalljen e moskompetencës lëndore për gjykimin e çështjes civile me Nr. 1572 regjistrimi datë 31.01.2013 regjistrimi.

Dërgimin e akteve gjykatës kompetente, Gjykatës të Apelit Administrativ, Tiranë."

Gjykata Administrative e Apelit;

Si u njoh me relatimin e gjyqtarës **Rilinda Selimi**, shqyrtoi aktet e dosjes dhe analizoi çështjen në tërësi;

V E R E N

Rrethanat e çështjes:

Paditësi shoqëria "Shpiragu/B" Sh.P.K. është themeluar në datë 17.01.1995, është regjistruar në QKR me NIPT J72603135F dhe ushtron aktivitet në fushën e prodhimit dhe shitjes së materialeve të ndërtimit, pllakave, gur i bardhë, çakull, gur gëlqere, granit e blloqe etj.

Në datën 06.03.2012 deri në 21.03.2012 inspektorët e Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Berat kanë ushtruar kontroll pranë shoqërisë për periudhën e veprimtarisë nga viti 2008, 2009, 2010, viti 2011 deri në Shkurt të vitit 2012. Kontrolli është kryer në bazë të "Autorizim për kryerje kontrolli" Nr. 499 Prot. datë 06.03.2012, "Njoftim për kontroll" Nr. 499/1 Prot. datë 06.03.2012 dhe "Program kontrolli" Nr. 492/2 Prot. datë 06.03.2012.

Nga akti i kontrollit i padituri ka konstatuar se nuk është paguar në masën e duhur renta minerare për vitin 2010 dhe për periudhën nga Korrik deri në Dhjetor 2011. Për këtë Drejtoria Rajonale e Tatimeve Berat ka lëshuar njoftim vlerësimit nr.1109 dt.05.04.2012, sipas të cilat shoqëria detyrohet të paguajë 403 410 lekë si detyrim tatimor dhe 201705 lekë gjobë.

Paditësi ka bërë ankim për anulimin e gjobës. Drejtoria e Apelimit Tatimor Tiranë ka marrë vendimin nr.10203/1 prot. dt. 07.08.2012 ku ka refuzuar ankimin, si të paraqitur jashtë afatit.

Në vijim paditësi i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat me kërkesë padinë objekt gjykimi.

Nga aktet e dosjes, rezulton se me vendimin Nr. 376 datë 12.03.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, është gjykuar konflikti gjyqësor, me palë paditës shoqëria "Shpiragu/B" Sh.P.K., e paditur Drejtoria Rajonale e Tatimeve Berat, me objekt 1. Anullimi pjesërisht i aktit administrativ

padinë aktuale për të pasur mundësinë e gjobës si dhe të parashkruar me argumentin se ka marrë formë të prerë, nëse paditësi do kish kërkuar me padinë aktuale shumë e detyrimit tatimor 403.410 lekë do të ishin para një situatë gjyqësore apo të litispëncës, të dyja paditë do të ishin të njëjta në të tre komponentët e saj, palë, objekt dhe shkak. Për sa i përket shumës së detyrimit tatimor 403.410 lekë se ka marrë formë të prerë, ky qëndrim i gjykatës është i gabuar, për arsye se kjo shumë ende nuk ka marrë formë të prerë pasi vendimi i Gjykatës së Apelit Vlorë nuk është dhënë akoma.

- Përfundimisht kërkojmë nga Gjykata e Apelit Vlorë ndryshimin e vendimit civil Nr. 1628 datë 23.11.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, në bazë të nenit 446/b të K.Pr.C. anulimin e gjobës 201.705 lekë për rentën minerare të rrjedhur nga njoftim vlerësimi Nr. 1109 datë 5.4.2012 për detyrimet tatimore. Shpenzimet gjyqësore ti ngarkohen të paditurit.

Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin Nr. 703 (60-2014-1009) date 22.04.2014 ka vendosur:

"Shpalljen e moskompetencës lëndore për gjykimin e çështjes civile me Nr. 1572 regjistrimi datë 31.01.2013 regjistrimi.

Dërgimin e akteve gjykatës kompetente, Gjykatës të Apelit Administrativ, Tiranë."

Gjykata Administrative e Apelit;

Si u njoh me relatimin e **gjyqtarës Rilinda Selimi**, shqyrtoi aktet e dosjes dhe analizoi çështjen në tërësi;

V E R E N

Rrethanat e çështjes:

Paditësi shoqëria "Shpiragu/B" Sh.P.K. është themeluar në datë 17.01.1995, është regjistruar në QKR me NIPT J72603135F dhe ushtron aktivitet në fushën e prodhimit dhe shitjes së materialeve të ndërtimit, pllakave, gur i bardhë, çakull, gur gëlqere, granit e blloqe etj.

Në datën 06.03.2012 deri në 21.03.2012 inspektorët e Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Berat kanë ushtruar kontroll pranë shoqërisë për periudhën e veprimtarisë nga viti 2008, 2009, 2010, viti 2011 deri në Shkurt të vitit 2012. Kontrolli është kryer në bazë të "Autorizim për kryerje kontrolli" Nr. 499 Prot. datë 06.03.2012, "Njoftim për kontroll" Nr. 499/1 Prot. datë 06.03.2012 dhe "Program kontrolli" Nr. 492/2 Prot. datë 06.03.2012.

Nga akti i kontrollit i padituri ka konstatuar se nuk është paguar në masën e duhur renta minerare për vitin 2010 dhe për periudhën nga Korrik deri në Dhjetor 2011. Për këtë Drejtoria Rajonale e Tatimeve Berat ka lëshuar njoftim vlerësimit nr.1109 dt.05.04.2012, sipas të cilat shoqëria detyrohet të paguajë 403 410 lekë si detyrim tatimor dhe 201705 lekë gjobë.

Paditësi ka bërë ankim për anulimin e gjobës. Drejtoria e Apelit Tatimor Tiranë ka marrë vendimin nr.10203/1 prot. dt. 07.08.2012 ku ka refuzuar ankimin, si të paraqitur jashtë afatit.

Në vijim paditësi i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat me kërkesë padinë objekt gjykimi.

Nga aktet e dosjes, rezulton se me vendimin Nr. 376 datë 12.03.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, është gjykuar konflikti gjyqësor, me palë paditës shoqëria "Shpiragu/B" Sh.P.K., e paditur Drejtoria Rajonale e Tatimeve Berat, me objekt 1. Anullimi pjesërisht i aktit administrativ

2. Shpenzimet gjyqsore në masën 12400 (dymbëdhjetëmijë e katërqind) lekë i mbeten paditësit, siç i ka bërë.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat, në lidhje me këtë vendim ka arsyetuar se:

- Cështja i përket për shqyrtim juridiksioni gjyqsor.

Paditësi ka dorëzuar ankimin në datën 02.05.2012 në postë, ndaj njoftim vlerësimit të detyrimit tatimor nr.1109 dt.05.04.2012, drejtuar Drejtorisë së Apelimit Tatimor Tiranë. Ky fakt konfirmohet nga dëftesa për pranimin e objekteve postare e datës 02.05.2012 e shërbimit postar Berat. Me paraqitjen e ankimit në shërbimin postar paditësi ka ushtruar të drejtën e tij të ankimit brenda afatit ligjor prej 30 ditësh nga njoftimi I aktit. Për më tepër paditësi një kopjo të ankimit drejtuar Drejtorisë së Apelimit Tatimor Tiranë e ka dorëzuar në Drejtorinë e Tatimeve Berat. Në interpretim të nenit 139 të K.Pr.Administrative pala e paditur duhet ta përcillte atë pranë organit kompetent të shqyrtimit të ankimit ose në të kundërt duhet t'ia kthente paditësit, që në momentin e paraqitjes duke e orientuar atë për dorëzimin e ankimit pranë Drejtorisë së Apelimit Tatimor. Në neglizhencë të plotë pala e paditur jo vetëm nuk ka nisur ankimin në organin kompetent, por as e ka njoftuar këtë të fundit, duke u bërë shkak për mosshqyrtimin e ankimit nga Drejtoria e Apelimit Tatimor, si të ngritur jashtë afatit. Me vendimin dt.07.08.2012 Drejtoria e Apelimit tatimor refuzon ankimit si të ngritur jashtë afatit, pasi paditësi e ka nisur atë gabimisht në Drejtorinë rajonale të tatimeve Tiranë.

.... Në rastin konkret rezultoi se paditësi ka bërë ankimin ndaj aktit njoftim vlerësimi tatimor të datës 05.04.2012 brenda afatit dhe cështja nuk është shqyrtuar nga Drejtoria e Apelimit jo për faj të tij. Dorëzimi I këtij ankimi në Drejtorinë e Rajonale Tatimore Tiranë ka qënë rezultat I mospërbushjes së rregullit të detyrës nga shërbimi postar. Drejtoria e Apelimit ishte e detyruar të bente verifikimet se kur dhe ku paditësi kishte nisur ankimit. Sipas nenit 108/2 të ligjit nr.9920 dt.19.05.2008 si dhe vendimit unifikues të Gjykatës së Lartë nr.3 dt.12.02.2008 Drejtoria e Apelimit nuk i ka dhënë asnjë mundësi paditësit për plotësimin e të metave të ankimit por apriori ka vendosur mosshqyrtimin e tij (pika 45 /d e vendimit unifikues). Drejtoria e tatimeve Berat nga ana tjetër nuk e ka njoftuar Drejtorinë e Apelimit tatimor për paraqitjen e kopjos tjetër të ankimit pranë saj. ..

- Së dyti: Vendimi I Drejtorisë së Apelimit tatimor është dhënë në datën 07.08.2012. Sipas shënimit të vendosur nga kryesekretaria e gjykatës padia është paraqitur në gjykatë në datën 05.09.2012. Pra, ajo është ngritur brenda afatit procedural 30 ditor nga njoftimi për ankimin në rrugë gjyqsore të aktit administrative.
- Paditësi kundërshton vetëm vlerën e gjobës me pretendimin se përderisa mosmarrëveshja për cmimin që duhet të aplikohet lidhur me rentën ishte në diskutim në një proces gjyqsor të parafilluar, gjëndja e paditësit nuk mund të ndryshohet dhe të rënohet me gjobë. Gjykata cmon se ky pretendim i paditësit është i pabazuar.

Njoftimi i vlerësimit tatimor përbën një akt administrative, ku krahas detyrimit tatimor parashikohet dhe gjoba që i ngarkohet subjektit. Në rastin konkret gjoba e vendosur është rezultat i mospërbushjes së detyrimit tatimor në masën e pretenduar nga organet tatimore për rentën minerale. Pra, ekzistenca e saj është e lidhur ngushtësisht me egzistencën e detyrimit tatimor të papaguar. Si e tillë ajo nuk përbën një denim të pavarur nga detyrimi kryesor. Edhe vlera e saj i referohet 50% të detyrimit të papaguar. Në këtë kontekst paditësi nuk mund të kërkojë anullimin e saj, pa kundërshtuar dhe detyrimin tatimor që ajo i referohet.

...I padituri ka pretenduar se paditësi nuk ka paguar në masën e duhur tatimin për

rentën minerare. Mbi këtë bazë krahas detyrimit kryesor ka aplikuar ndaj tij gjobën në masën 50% të vlerës së detyrimit. Neni 117 i ligjit nr.9920 ku bazohet i padituri parashikon se: Agjenti i mbajtjes së tatimit në burim apo agjenti i taksave, që nuk arrin të mbajë, të llogarisë, të raportojë dhe të transferojë në Buxhetin e Shtetit tatimin në burim apo tatimet dhe taksat e mbledhura, apo i shmanget mbledhjes së tyre, detyrohet të paguajë gjobë të barabartë me 50 për qind të shumës së plotë të tatimit të pambledhur apo të shmangur. Nga kjo dispozitë del se gjoba është rrjedhojë e mospërmbushjes korrekte të detyrimit tatimor nga agjenti tatimor. Qëllimi kryesor i veprimtarisë së organeve tatimore është pagimi në përputhje me ligjin i tatimeve. Mospagimet korrekte rregullohet nëpërmjet lëshimit të njoftimeve nga organet tatimore që kanë për qëllim rikuperimin e detyrimit tatimor të papaguar. Nga ana tjetër veprimet e kundraligjshme të subjektit janë të dënueshme me gjobë. Për atë kohë sa do të egzistojë detyrimi tatimor pjesë e njoftim vlerësimit, provohet fakti se subjekti tatimor nuk ka përmbushur sic duhet detyrimet tatimore me të cilat e ngarkon ligji. Pra, fakti i paligjshmërisë së veprimit të subjektit rezulton i provuar.

Duke qënë se paditësi nuk e ka kundërshtuar njoftim vlerësimin për detyrimin tatimor, akti administrative për këtë pjesë ka marrë formë të prerë. Ky fakt provon se nëpërmjet qëndrimit të tij paditësi ka pranuar se për vitin 2010 dhe për gjysmën e vitit 2011 nuk ka paguar sic duhet detyrimin tatimor për rentën minerale. Mbi këtë bazë dënimi me gjobë i këtij veprimi të kundraligjshëm, është rrjedhim i zbatimit të ligjit në mënyrë të drejtpërdrejtë.

- Si detyrimi tatimor ashtu dhe dënimi me gjobë janë njëkohësisht të aplikueshëm dhe rrjedhin nga I njëjti fakt I paligjshëm, kjo në bazë të nenit 69 e 111 të ligjit nr.9920 dt.19.05.2008. Paditësi pretendoi se I padituri nuk mund të vendoste gjobën pasi rëndonte kështu pozitën e paditësit. Sipas tij për shkak të një procesi civil ku diskutohej se cila do të ishte baza e përlllogaritjes së detyrimit tatimor për rentën minerale, marrëdhënia materiale midis palëve duhet të qëndronte e pandryshuar. Ky pretendim i paditësit është i pabazuar pasi:

Në rast se do të pranohej llogjika e paditësit se marrëdhënia juridike materiale midis palëve do të mbetej e pandryshuar deri sa të zgjidhej përfundimisht pretendimi i tij, ky kërkim i paditësit do të vlente para së gjithash për detyrimin tatimor, I cili ka për bazë të njëjtën mënyrë llogaritje të kontestuar nga paditësi. Është detyrimi tatimor që shfaq qëndrimin e të paditurit për përlllogaritjen e rentës minerale në të njëjtën mënyrë. Dënimi me gjobë është pasojë e këtij detyrimi dhe si e tillë nuk cënon marrëdhënien e palëve.

- Paditësi ka mbështetur padinë e tij në nenin 131/b dhe 135 të K.Civil. Ky nen parashikon se parashkrimi ndërpritet me paraqitjen e padisë, kundërpadisë ose prapësimit qoftë në gjykatë ose arbitrazh që nuk është kompetent për shqyrtimin e çështjes. Gjykata cmon se ngritja e padisë nuk gjen mbështetje në bazën ligjore të sipërcituar. ... Objekt I padisë së ngritur nga paditësi në datën 13.12.2011 I referohet njoftim vlerësimit nr.2450 të datës 04.08.2011 dhe jo atij të datës 05.04.2012. Pra, në dy rastet kemi të bëjmë me detyrime të ndryshme tatimore.

Dënimi me gjobë i dhënë nga drejtoria e tatimeve me njoftim vlerësimin e datës 05.04.2012 i referohet detyrimit tatimor të përmbajtur në këtë akt dhe jo atij objekt i shqyrtimit të padisë së datës 13.12.2011.

....Në asnjë prej ligjeve të posacme nuk njihet si koncept ndërprerja e të drejtës së organeve administrative të nxjerrin akte administrative, ashtu sic pretendon paditësi. Ky i fundit i referohet pikërisht ngritjes së padisë ndaj aktit administrativ të datës 04.08.2011 për të pretenduar ndërprerjen e të drejtës së organeve administrative në nxjerrjen e aktit

administrative të datës 05.04.2012, kërkim ky që nuk gjen asnjë mbështetje ligjore. Nxjerrja e akteve administrative i referohet një procedure të caktuar ligjore që në rastin konkret ka të bëjë si me realizimin e kontrollit tatimor, njoftimin e tij dhe lëshimin e aktit në formën e kërkuar nga ligji. Kodi i Procedurës Administrative njeh vetëm institutin e pezullimit të zbatimit të aktit administrative sipas nenit 138 të K.Pr. Administrative, i cili është tërësisht i ndryshëm nga ai i ndërprerjes ose të pezullimit të parashkrimit sipas të drejtës civile. Ankimi kundër një akti administrative nuk pengon organet administrative të nxjerrin akte të tjera administrative ndaj së njëjtës palë për periudha të tjera tatimore edhe pse ato mbajnë të njëjtin qëndrim juridik për trajtimin e diferencës së detyrimit tatimor si në rastin objekt shqyrtimi...”

Paditësi përmes ankimit kërkon ndryshimin e vendimit dhe pranimin e padisë duke pretenduar në thelb se vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat është rrjedhojë cilësimeve të gabuar të objektit të mosmarrëveshjes dhe në kundërshtim me ligjin ka vendosur rrëzimin e padisë. Çështja është regjistruar për gjykim pranë Gjykatës Administrative të Apelit, dërguar për kompetencë lëndore nga Gjykata e Apelit Vlorë me vendimin 703 date 22.04.2014, si çështje administrative në baze të neneve 4 dhe 7 të Ligjit nr. 49/2012 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative” si mosmarrëveshja administrative, në mbështetje edhe të Vendimit Unifikues nr. 3 dt. 06.12.2013 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Vlerësimi i Gjykatës Administrative të Apelit:

Kolegji i Gjykatës Administrative të Apelit në shqyrtim të rrethanave të çështjes, pretendimeve dhe prapësimeve të palëve si dhe materialeve të dosjes, çmon se ankimi i paditësit nuk përmban shkaqe për çënimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat pasi çmon se kërkitimi për anulimin e gjobës përmbajtur në njoftim vlerësimin tatimor është pa mbështetje ligjore.

Kolegji çmon të drejtë arsyetimin e gjykatës së shkallës së parë se kërkitimi i paditësit është në juridiksionin gjyqësor. Ky përfundim është rrjedhojë e interpretimit dhe zbatimit korrekt të ligjit material në faktet gjyqësore të çështjes, si dhe në përmbushje të udhëzimeve të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë në vendimin unifikues nr.3 dt.12.02.2008 . Konstatohet se pala paditëse rezulton të ketë paraqitur ankim konform përcaktimeve të ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 24/2008 në zbatim të tij. Ky ankim ka mbërritur me vonesë pranë Drejtorisë së Apelit Tatimor jo për faj të paditësit. Ky fakt konfirmohet nga dëftesa për pranimin e objekteve postare e datës 02.05.2012 e shërbimit postar Berat. Dorëzimi i këtij ankimi në Drejtorinë e Rajonale Tatimore Tiranë ka qënë rezultat i mospërmbushjes së rregullt të detyrës nga shërbimi postar. Gjithashtu, gjykata e shkallës së parë konstaton drejt se padia është paraqitur në gjykatë brenda afatit 30 ditor.

Në lidhje me shqyrtimin e kërkitimit të paditësit për shfuqizimin e gjobës në shumën prej 201.705 lekë provohet se ky penalitet është rrjedhojë e vlerësimit të palës së paditur Drejtoria Rajonale Tatimore Berat se paditësi për vitin 2010 dhe për periudhën nga Korrik deri në Dhjetor 2011 nuk ka përlllogaritur dhe paguar në masën e drejtë taksën e rentës minerare.

Në piken 4 të nenit 4 të ligjit nr.9975 date 28.07.2008 “Për taksat kombetare” parashikohet:

“4. Taksa e rentes minerare caktohet sipas shtojces nr. 2, që i bashkelidhet këtij ligji dhe është pjese perberese e tij. Çdo person fizik apo juridik, që është i licencuar dhe/ose vepron në industrinë minerare, sipas një marrëdhënieje kontraktuale me ministrin pergjegjes për ekonomine,

duhet te paguaje rente minerare per burimet natyrore qe nxjerr nga/mbi/dhe nentoka e territorit te Republikes se Shqiperise. Renta minerare llogaritet si detyrim mujor i subjektit taksapagues, ne çastin kur ai shet produkte minerare.

Ne rastin e eksportit te produkteve minerare, renta paguhet ne çastin e berfjes se deklarates se eksportit. 25 per qind e te ardhurave nga renta minerare i kalojne pushtetit vendor ku zhvillohet veprimtaria.

Renta minerare percaktohet duke shumezuar vleren e pergjithshme te shitjes me shumice te produktit me perqindjen e rentes, sipas percaktimeve te shtojces nr.2, qe i bashkelidhet ketij ligji.

Pagesa e rentes minerare behet brenda dates 15 te muajit pasardhes, kur jane realizuar shitjet.

Deget e doganave ne rrethe ngarkohen per arketimin e kesaj rente, ne rastin e eksportit te produkteve minerare, ndersa deget e tatimeve ngarkohen per arketimin e kesaj rente, ne rastin e shitjes se produkteve minerare brenda vendit. Vlera ne perqindje e rentes minerare, e percaktuar ne ligjin minerar, ndryshon sipas paragrafeve te pare e te dyte te pikes 4 te nenit 4 te ketij ligji. Percaktimi i vleres se rentes se pasurise minerare, per te gjitha mineralet, sipas percaktimeve te ligjit, kryhet ne perputhje me percaktimet e bera ne shtojcen nr. 2, qe i bashkelidhet ketij ligji.

Keshilli i Ministrave percakton procedurat e arketimit se rentes minerare dhe dokumentacionin qe duhet te paraqese i licencuari, eksportuesi, per te vertetuar çmimin e shitjes. Ne mungese te ketij dokumentacioni, organi i ngarkuar nga ky ligj per arketimin e taksas se rentes minerare, ben rivleresimin, mbeshketur ne metoda alternative."

Aplikimi i gjobës është rrjedhojë e zbatimit të nenit 117 të Ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar dhe konsiston referuar dhe akt kontrollit në vlerën 50 % të detyrimit për rentën minerare të papaguar.

Sipas kësaj dispozite rregullohet se:

"Agjenti i mbajtjes së tatimit në burim, agjenti i taksave apo tarifave, që nuk arrin të mbajë, të llogarisë, të raportojë dhe të transferojë në Buxhetin e Shtetit tatimin në burim apo tatimet, taksat dhe tarifatat e mbledhura, apo i shmanget mbledhjes së tyre, detyrohet të paguajë gjobë të barabartë me 50 për qind të shumës së plotë të tatimit, taksës apo tarifës së pambledhur apo të shmangur."

Bazuar në objektin e kërkimit të palës paditëse si dhe shkakun e ngritjes së padisë, Kolegji vlerëson se me të drejtë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat ka cmuar për rrëzimin e padisë.

Pretendimi i paditësit se pala e paditur nuk mund të vendoste penalitet ndaj tij më argumentimin se rëndon pozitën e tij pasi në një tjetër proces gjyqësor është në vlerësim qëndrimi i të paditurit në lidhje me mënyrën e llogaritjes së detyrimit për rentë minerare është pa bazë ligjore.

Marrëdhëniet e administratës tatimore me tatimpaguesin rregullohen nga legjislacioni tatimor. Ky i fundit vendos të drejta dhe detyrime në funksion të llogaritjes dhe arketimit të detyrimeve sipas percaktimeve ligjore. Ne nenin 68 të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në RSH" percaktohet se Vleresimi tatimor eshte :

a) është llogaritja e detyrimit tatimor të tatimpaguesit nga administrata tatimore;

b) në rastet kur shuma e detyrimit tatimor të vetëdeklaruar nuk paguhet, është njoftimi, që kërkon pagesën e detyrimit tatimor në datën e percaktuar në ligjin përkatës.

Ndersa ne Udhezimin nr.24, date 02.09.2008 ne piken 68.3.1 percaktohet se : "Administrata tatimore ka autoritetin dhe detyrimin për te mbikëqyrur te gjithë procesin e vlerësimit te detyrimeve tatimore te personave te tatueshëm. Ajo mund te beje një vlerësim te detyrimit tatimor te personit te tatueshëm... "

Sa sipër administrata tatimore ka legjitimitimin te nxjerre njoftim vleresimin per detyrime tatimore. Ne rastin konkret kjo ka qene dhe baza ligjore mbi te cilen ka vepruar Drejtoria Rajonale Tatimore Berat në ushtrim të veprimtarisë së saj administrative për kryerjen e vlerësimit tatimor.

Gjykata arsyeton drejt se, njoftimi i vlerësimit tatimor përbën një akt administrativ, ku krahas detyrimit tatimor parashikohet dhe gjoba që i ngarkohet subjektit. Në rastin konkret gjoba e vendosur është rezultat i mospërmblotjes së detyrimit tatimor në masën e pretenduar nga organet tatimore për rentën minerare. Pra, vendosja e saj është e lidhur ngushtësisht me ekzistencën e detyrimit tatimor të papaguar. Si e tillë ajo nuk përbën një denim të pavarur nga detyrimi kryesor. Edhe vlera e saj në zbatim të nenit 117 të ligjit i referohet 50% të detyrimit të papaguar. Andaj arsyetohet drejt se paditësi nuk mund të kërkojë anulimin e saj, pa kundërshtuar dhe detyrimin tatimor që ajo i referohet.

Përsa kohë objekt i gjykimit nuk është kundërshtimi i detyrimit për rentën minerare, si dhe nuk parashtrihen kundërshtime në lidhje me masën e gjobës së aplikuar sipas nenit 117 të ligjit nr. 9920/2008, pretendimet e palës paditëse për mosveprim të administratës tatimore për penalizimin e saj deri sa gjyqësisht të shqyrtohet vendimarrja e të paditurit në një akt tjetër vlerësimi tatimor lidhur mënyrën e llogaritjes së rentës minerare e për një periudhë tjetër tatimore janë të papranueshme dhe pa asnjë bazë ligjore që përlligj ato.

Kolegji, duke vlerësuar se kërkimi i palës paditëse nuk mbështetet në një shkak të ligjshëm, cmon se duhet të disponojë me lënien në fuqi të vendimit nr. 1628 datë 23.11.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat. Në përfundim, Kolegji cmon të shprehet se, pasur parasysh vlerën e penaltetit të permbajtur në njoftim vlerësimin për detyrimet tatimore nr.1109 dt.05.04.2012 objekt kundërshtimi si dhe përcaktimet e nenit 56 të Ligjit nr. 49/2012, përfundohet se ndaj këtij vendimi nuk lejohet rekurs.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Administrative e Apelit, mbështetur në nenin 50, gërma "b" të Ligjit nr. 49/2012 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative",

V E N D O S I

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 1628 datë 23.11.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat.
2. Kundër këtij vendimi nuk lejohet rekurs.

U shpall në Tiranë, sot më datë 27.04.2016.

ANËTAR
Bari SHYTI
(d.v)

ANËTAR
Amarildo LAÇI
(d.v)

KRYESUESE
Rilinda SELIMI
(d.v)

E njesuar me origjinalin

Kancelari
Leonard Steboj
Beboj